Shqiperia humb testin kunder Ukraines

nga Administrator
E hënë, 06 Qershor 2016 08:50

Te premten Shqiperia ka humbur ne nje test shume te rendesishem kunder ekipit te Ukraines. Ekipi yne kombetar ka zhvilluar nje pjese te pare te mire por perseri gabimet ne repartin mbrojtes dhe pakujdesia na ka ndeshkuar.
Ukrainasit kane kaluar shpejt ne avantazh, me ane te Stepanenko, ne minuten e 8', i cili ka perfituar nga pergjumja e ekipit tone. Reagimi i lojtareve te kombetares eshte i menjehershem, ku ne minuten e 12 ka qene Sadiku ai qe ka barazuar rezultatin. Roshi ka dhene nje asist te bukur per Sadikun i cili ka goditur bukur me te djathten duke shenuar golin e rradhes per kuqezinjte.
Pas golit, djemte e kombetares te mbeshtetur edhe nga pothuajse 10 mije tifozet, kane kerkuar edhe golin e avantazhit me ane te Sadikut, por portieri mik ka pritur.
Pjesa e pare mbyllet ne barazim 1-1, me kombetaren tone qe ka kerkuar golin e avantazhit dhe me nje loje te mire.
Ne pjesen e dyte, tranjeri De Biazi ben 3 zevendesime: Basha hyn per Xhaken, Memushaj per Abrashin dhe Ajeti per kapitenin Cana.
Loja fillon e shpejte, dhe Ukrainasit kalojne serish ne avantazh. Konoplyanka kroson nga e majta, aty ku Zozulya godet me koke, Berisha largon topin ne kembet e Yarmolenkos i cili e ka te lehte te shenoje. Minuta e 49 e ndeshjes 2-1.
Shqiperia reagon dhe kerkon me ngulm golin e barazimit, 2-3 raste te mira por nuk shfrytezohen nga lojtaret tane. Ne minuten e 58, do te jete Lenjani qe ben nje gjuajtje te bukur por vetem shtylle.
De Biasi ben edhe nderrimet e tjera duke aktivizuar ne fushe 3 sulmues. Ukraina mbrohet mire dhe me ane te kundersulmit shenon edhe golin e 3-te me Konoplyanka ne minuten e 88.
Mbyllet keshtu takimi Ukraine - Shqiperi me rezultatin 3-1. Nje Shqiperi me 2 ftyra, ku ne pjesen e pare luan mire por vuan gjithmone nga gabimet dhe nga pakujdesia.
Tashme ne ditet e fundit para fillimit te kampionatit, De Biasit i duhet te punoje shume qe te korigjoje keto gabime.